

V E N D I M
Nr.329, datë 17.5.2001

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “MILOT-LEZHË”, NË
RRETHIN E LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për inters publik, të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Lezhë, në rrethin e Lezhës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të cilët do të shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për një përfaqe të përgjithshme 4 828 m2 tokë/arë. 1m2 tokë/arë është vlerësuar me 600.9 lekë m2, dhe vlera e përgjithshme arrin shifrën 2 928 745 (dy milionë e nëntëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e dyzet e pesë) lekë.
 4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2001, zëri “shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit .
 5. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.5.2001.
 6. Ngarkohet Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Lista e personave që shpronësohen për efekt të segmentit rrugor
Milot-Lezhë-Qytet Lezhë

Nr	Pronarët			Nr. i parcelës	Siperf. në m2	Çmimi l/m2	Kulturë bujqësore	Totali lekë
	Emri	Atësia	Mbiemri					
						600.9		
1	Gjek	Martin	Leka	180/7	666			
2	Lula	Kol	Lleshi	104/15	1099			
3	Mark	Gjok	Ivanaj	104/1	1064			
4	Vat	Marash	Ivanaj	105/1	1179			
5	Rrok	Gjok	Narkaj	140/7	130			
6	Pashk	Zef	Dodaj	140/6	294			
7	Pjetër	Zef	Cali	140/10	315			
8	Mark	Nikoll	Malaj	95/12	81			
	Shuma				4828	600.9		2901145

Shpenzimet e publikimit për këtë segment rrugor kapin shifrën prej 27 600 lekë.

Totali: 2928745

Mbyllet me numër rendor 8(tetë)